EUROPEAN CENTRE
FOR MINORITY
ISSUES KOSOVO

INFORMATIONAL BULLETIN

3 DHJETOR 2014

SFIDAT NË PROCESIN E INTEGRIMIT NË KOSOVË: EMIGRIMI NË RRITJE I ROMËVE, ASHKALINJËVE, DHE EGJIPTASËVE

Rreth ECMI Kosova

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare e përfshirë në çështje minoritare në Kosovë, me qëllim të gjithëmbarshëm që të zhvillojë institucione gjithëpërfshirëse, përfaqësuese, të ndjeshme ndaj komuniteteve e që përkrahin një Kosovë stabile shumetnike. ECMI Kosova kontribuon për zhvillimin, fuqizimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, përkrah institucionalizimin e organeve qeveritare që punojnë me komunitetet, dhe shton kapacitetet e aktorëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për t'u përfshirë me njëri-tjetrin në një mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.

Str. Nëna Terezë Nr. 41, Apt. 29, 10000 Prishtinë/Priština, Kosovo, Tel. +381 (0) 38 224 473
Str. Cika Jovina Nr. 3, 1st Fl, 38220 Mitrovica/Mitrovicë North, Kosovo, Tel. +381 (0) 64 00 55 488

INFORMATIONAL BULLETIN

Është raportuar në mënyrë alarmuese nga e tërë Kosova për emigrimin e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasëve nga Kosova drejt vendeve perëndimore. Thuhet se një numër në rritje individësh, dhe madje edhe familje të tëra, kanë emigruar në vendet perëndimore përmes rrugëve ilegale. Edhe pse është raportuar se shqiptarë të Kosovës janë duke e lënë Kosovën për Evropën perëndimore gjithashtu, megjithatë komunitetet pakicë rom, ashkali dhe egjiptian janë veçanërisht të prekur nga ky trend. Këto tri komunitete janë ndër më të cenueshmit në Kosovë, dhe numri në rritje i individëve dhe familjeve që lëshojnë Kosovën paraqet një trend shqetësues që duhet të trajtohet në mënyrë të menjëhershme nga institucionet përkatëse të Kosovës. Ky raport sjell së bashku disa gjetje statistikore për valën e fundit të emigrimit, si dhe arsyet e raportuara për emigracionin dhe rrugët e emigracionit, në mënyrë që të bëjë rekomandime afatshkurtra dhe afatgjata për Qeverinë e Kosovës.

ECMI Kosova ka pranuar disa raporte nga terreni sipas të cilëve një numër në rritje individësh dhe familjesh kanë emigruar jashtë Kosovës gjatë dy muajve të fundit. Kjo valë e re e migrimit është veçanërisht e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas. Ndonëse është vështirë të gjenden shifra konkrete, në intervistat tona me zyrtarë komunalë në tërë Kosovën kemi marrë statistikat në vijim, bazuar në informatat e tyre:

- Në Ferizaj, më shumë se 150 familje (rreth 1,000 persona) e kanë lënë këtë qytet brenda disa javëve të fundit.[1]
- Sa i përket Gjakovës, ndonëse nuk është dhënë ndonjë deklaratë zyrtare mbi numrin e përgjithshëm të emigrantëve nga kjo komunë, zyrtarët e Zyres për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) spekulojnë se gati 80-100 persona kanë migruar.[2]
- Nuk ka të dhëna zyrtare në lidhje me numrin e saktë të emigrantëve nga Peja, ndonëse zyrtarët raportojnë se trendi është në rritje.[3]
- Thuhet se gjatë muajve të fundit 3 familje nga komuniteti rom janë larguar nga Kamenica.[4]
- Sa i përket Fushë Kosovës, 170 familje, gjë që arrin në mbi 800 individë, janë larguar nga kjo komunë.[5]
- Rreth 300 persona janë larguar nga Prizreni kohët e fundit, dhe të tjerë vazhdojnë të largohen çdo ditë.[6]
- Në Obiliq, zyrtare komunale kanë konfirmuar se 25 familje janë larguar, ndërsa është raportuar se edhe 26 familje të tjera kanë emigruar.[7]

[1] Intervistë e ECMI Kosovës me zyrtarë të ZKKK-së në Ferizaj, nëntor 2014.
[2] Intervistë e ECMI Kosovës me zyrtarë të ZKKK-së në Gjakovë, nëntor 2014.
[3] Intervistë e ECMI Kosovës me përfaqësues politikë të komunitetit egjiptas në Pejë, nëntor 2014.
[4] Intervistë e ECMI Kosovës me zyrtarin e ZKKK-së, z. Bajrush Kriezi, në Kamenicë, nëntor 2014.
[5] Intervistë e ECMI Kosovës me Nënkryetarin e Komunës për Komunitete në Fushë Kosovë, Halil Qerimi, nëntor 2014.
[6] Intervistë e ECMI Kosovës me zyrtarin e ZKKK-së Islam Elshani, nëntor 2014.

Në këtë drejtim, Agjensioni Kosovar për Avokim dhe Zhvillim (KAAD) së fundmi ka koordinuar një letër të hapur Kryeministrit, dërguar në emër të Platformës së OJQ-ve që punojnë me komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas, në të cilën kanë vlerësuar se mbi 360 familje rome, ashkali dhe egjiptase (që arrijnë në 1,700 persona) e kanë lëshuar Kosovën.

ECMI Kosova ka zhvilluar një sërë intervistash me familjet anëtarët e të cilëve tashmë kanë emigruar ose po planifikojnë të largohen. Shumica e tyre përmendin kushtet e këqija sociale dhe ekonomike. Sa i përket migrimit për shkak të gjendjes socio-ekonomike, ZKKK në Gjakovë ka informuar ECMI Kosovën se qytetarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas u kanë thënë atyre se po largohen, ndër të tjera, për shkak të mungesës së mundësive të punësimit. Informata të ngjashme kemi marrë edhe nga komuna e Lipjanit.[8]

Ndryshimet e raportuara në skemën e Mirëqenies Sociale të Kosovës, të cilat e vështirësojnë marrjen e përfitimeve të mirëqenies sociale nëse fëmijët nuk ndjekin shkollimin rregullisht, kanë pasur ndikim serioz në ekonomitë e tyre familjare. Heqja nga skema e ndihmës sociale gjithashtu është përmendur si faktor kontribuues në migrim.[9] Sipas skemës së mirëqenies sociale kërkohet që fëmijët të ndjekin shkollën rregullisht. Si rezultat i kësaj, disa familjeve u është ndërprerë dhënia e ndihmave përmes skemës së ndihmës sociale, pasi që shumë i kanë hequr fëmijët e tyre nga shkolla me qëllim që të gjenerojnë të ardhura shtesë. Ky faktor mund të ketë kontribuar në emigrimin e familjeve rome, ashkali dhe egjiptase.

Ekziston një besim i përgjithshëm në mesin e komuniteteve jo-shumicë, si dhe në mesin e shqiptarëve që emigrojnë, se Gjermania dhe vendet e tjera perëndimore do të japin azil. Për shkak të thashethemeve dhe dezinformatave, duket se shumë familje kanë fituar përshtypjen se Kancelarja gjermane, Angela Merkel, ka deklaruar se gjatë 5 viteve të ardhshme Gjermania nuk do të kthejë azilkërkuesit nga Kosova që u përkasin komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas.[10] ECMI Kosovës gjithashtu i është raportuar se ata të cilët tashmë kanë arritur në Gjermani u kanë thënë të afërmve të tyre në Kosovë se janë pranuar nga vendi pritës (Gjermania). Ata u kanë shpjeguar të afërmve të tyre se Gjermania u ka dhënë ndihmë sociale për një periudhë fillestare prej tre muajsh.[11] Është raportuar gjithashtu se Franca ka marrë një vendim për anulimin e vendimit të saj, të datës 16 dhjetor 2013, sipas të cilit Kosova ishte klasifikuar si 'vend i sigurt', vendim që e vështirësonte dhënien e azilit për shtetasit e Kosovës. Vendimi i ri

[7] Intervistë e ECMI Kosovës me zyrtarë të ZKKK-së në Obiliq, nëntor 2014.
[8] Intervistë e ECMI Kosovës me Zyrtarin e ZKKK-së Fatmir Goliq, nëntor 2014.
[9] Intervistë e ECMI Kosovës me zyrtarë të ZKKK-së në Gjakovë, nëntor 2014.
[10] Intervistë e ECMI Kosovës me zyrtarë të ZKKK-së në Gjakovë, nëntor 2014.
[11] Intervistë e ECMI Kosovës me Zyrtarin e ZKKK-së Fatmir Goliq, nëntor 2014.

e heq Kosovën nga lista e vendeve të sigurta, gjë që e bën më të lehtë dhënien e azilit për shtetasit e Kosovës.[12] Kontaktet e ECMI Kosovës në Ministrinë e Punëve të Brendshme kanë konfirmuar raportimet se MPB është duke hetuar grupet e supozuara të organizuara përgjegjëse për përhapjen e thashethemeve dhe dezinformatave në mesin e komuniteteve të cenueshme. Zyrtarë të MPB-së i kanë thënë ECMI Kosovës se këto grupe të organizuara janë duke i 'mashtruar' qytetarët që të shesin apo braktisin pronat e tyre ë Kosovë dhe të emigrojnë në BE; këto grupe pastaj keqpërdorin çfarëdo pronë që mbetet këtu.[13]

Pothuajse të gjitha familjet marrin një rrugë drejt vendeve perëndimore. Marrëveshja e Brukselit për Lirinë e Lëvizjes mes Kosovës dhe Serbisë u lejon shtetasve të Kosovës të kalojnë në Serbi me letërnjoftim, duke ua mundësuar atyre të arrijnë kufirin e një vendi të BE-së (Hungarisë) pa vizë, duke rritur kështu mundësitë e emigrimit të tyre (të paligjshëm), fillimisht në Hungari, e pastaj në Gjermani dhe vende të tjera perëndimore. Megjithatë, raporte të fundit sugjerojnë se Policia e Kosovës u ka ndaluar rreth 300 shqiptarëve të Kosovës që të dalin në Serbi.[14]

Rekomandimet:

Afatshkurtra:

1. Më 6 nëntor, 'Platforma e OJQ-ve që merren me çështje të romëve, ashkalive dhe egjiptasve në Kosovë' i ka dërguar një letër të Kryeministrit në detyrë, Hashim Thaçi, përmes së cilës kanë ngritur shqetësimet e tyre rreth valës së migrimit të qytetarëve që u përkasin komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas. Në këtë letër gjithashtu i është kërkuar Kryeministrit në detyrë që të rifillojnë përpjekjet për zbatimin e Strategjisë së Kosovës për Integrimin e romëve, ashkalive dhe egjiptasve, që të zhvillohet një fushatë informuese për t'i njoftuar qytetarët mbi rreziqet e emigrimit të paligjshëm, dhe që të formohet një Task Forcë mandati i së cilës do të ishte që të analizojë kushtet sociale në të cilat gjenden këto komunitete dhe të propozojë zgjidhje konkrete.'Platforma' përbëhet nga disa OJQ me seli në Kosovë që merren me çështje të minoriteteve dhe veçanërisht me çështje që lidhen me romët, ashkalitë dhe egjiptasit: Balkan Sunflowers, Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë (ECMI Kosova), Shëndeti për të Gjithë, Agjencia e Kosovës për Avokim dhe Zhvillim (KAAD), Qendra Dokumentuese e Romëve dhe Ashkali, dhe Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptasve.

[12] Për me tepër informata, ju lutemi vizitoni: <http://koha.net/?id=27&l=34854>
[13] Intervistë e ECMI Kosovës me zyrtarin e MPB-së, z. Fitim Qerimi, 24 nëntor, 2014.
[14] Për me tepër informata, ju lutemi vizitoni: < http://koha.net/?id=27&l=34408>

2. Kosova duhet të adresojë urgjentisht shqetësimet në rritje se ndryshimet e fundit në sistemin e mirëqenies kanë krijuar një gjendje të paqëndrueshme ekonomike për komunitetet në nevojë, në përgjithësi, dhe ata romë, ashkali dhe egjiptas, në veçanti.

3. Kosova ka ndërmarrë më herët fushata publike me synim edukimin e popullsisë mbi rreziqet e migrimit ilegal, por deri më tani nuk është plasuar asnjë deklaratë apo mesazh u tillë për këtë çështje. Me rritjen e papritur dhe alarmante të migrimit të paligjshëm që prek komunitetet minoritare – por sigurisht jo i kufizuar vetëm në ta – institucionet e Kosovës duhet urgjentisht të ndërmarrin një fushatë të informimit publik me fokus në valën e fundit të migrimit.

Rekomandimet afatgjata:

1. Strategjia e Kosovës për Integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkali, dhe Egjiptas është dokument gjithëpërfshirës që duhet të zbatohet në mënyrë të vazhdueshme. Kosova duhet të ri-fokusojë energjitë në zbatimin e pjesëve të kësaj strategjie që janë konkrete dhe të arritshme në aspektin afatmesëm dhe afatgjatë. Kosova duhet ta ndërlidhë e zbatimin e Strategjisë me ministri të veçanta dhe, ndoshta më e rëndësishmja, të sigurojë përllogaritje të kostos për programet.
2. Të vazhdohet me zbatimin e Strategjisë në nivelin lokal. Shumica e problemeve me të cilat përballen komunitetet mund të zgjidhen në nivelin lokal:. arsimi, punësimi, mirëqenia sociale, etj. Për aq sa është e përshtatshme dhe e arsyeshme, të ndërlidhet zbatimi i Strategjisë me projektet e zhvillimit lokal të financuara nga ana e institucioneve të nivelit qendror;
3. Pasi që këto tri komunitete janë disa nga grupe qytetarësh më të pafavorizuar ekonomikisht, duhet bërë përpjekje serioze si nga institucionet qendrore ashtu edhe ato korale për të promovuar vetë-punësimin, veçanërisht në fushat e industrive ku pjesëtarët e këtyre komuniteteve janë tashmë aktivë. Kjo mund të arrihet duke i trajnuar ata në shkolla profesionale; gjithashtu duhet të shfrytëzohen qendrat rajonale për trajnime profesionale, së bashku me programet që kanë për qëllim rritjen e shkathtësive dhe punësueshmërisë së tyre në treg.
4. Qeveria duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë arsimit të rinisë rome, ashkali, dhe egjiptase:
    a. Nivel qendror dhe lokal duhet të marrin veprime për të zbatuar dhe institucionalizuar mekanizmat ekzistuese për parandalimin e braktisjes së shkollës dhe të reagimit. Planet vjetore të arsimit në nivel qendror dhe komunal duhet të fokusohen në çështjen e fëmijëve jashtë sistemit shkollor, dhe të kërkojnë llogaridhënie nga administratorët e shkollave dhe nga prindërit. Qeveria duhet të investojë në përmirësimin e kapaciteteve të profesionistëve komunalë dhe shkollorë për të siguruar që politikat e parandalimit të braktisjes së shkollës

ndjeken me veprime konkrete. Ekziston nevoja për staf shtesë nëpër shkolla, duke përfshirë psikologë dhe punëtorë social.

b. Shkollat e mesme teknike, profesionale, dhe të përgjithshme duhet t'i përgatisin studentët jo vetëm për vazhdimin e arsimit në nivel universitar, por edhe për treg të punës. Struktura e përgjithshme e përfitimeve sociale duhet të rishikohet me synim arritjen deri te fëmijët e ndjeshëm, sidomos gjatë periudhave kyçe të arsimit të tyre.

5. Të vihet fokusi në përmirësimin e ekonomisë dhe krijimin e kushteve për rritje të punësimit të të gjithë qytetarëve të Kosovës përmes rritjes së investimeve, ofrimit të trajnimeve dhe financimit të shkollave profesionale, gjithashtu duke dizajnuar programe specifike që kanë për cak personat e pakualifikuar për tregun aktual, etj..